



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E KULTURES  
AGJENCIA E SHËRBIMIT ARKEOLOGJIK

**Lënda:** LISTA E DOKUMENTACIONIT TEKNIKO-LIGJOR QË DUHET DORËZUAR PËR PËR KËRKESAT PËR LICENCË PROFESIONALE INDIVIDUALE PËR VEPRIMTARI ARKEOLOGJIK "A1", PËR VËZHGIM ARKEOLOGJIK (SYRVEY)

*Kjo listë ka vetëm vlerë orientuese, në çdo rast ASHA do të vlerësojë aplikimin dhe do të përcaktojë rast pas rasti dokumentacionin e nevojshëm sipas legjislacionit në fuqi.*

- 1. Kërkesë me shkrim në formë autobiografie teknike (Curriculum Vitae) me të dhëna kryesore:**
  - a) Emri, atësia, mbiemri, kopje të kartës së identitetit, vendlindja, adresa, vendi i punës, numri i telefonit dhe dy kopje fotografish 3x4cm.
  - b) Llojet e veprimtarisë që kërkon të kryejë, sipas kategorive dhe llojeve të përcaktuara.
- 2. Pagesa e tarifës së aplikimit** miratuar me Urdhërin e Ministrit Nr. 384, datë 21.10 2015.
- 3. Diplomë e shkollës së lartë në fushën e histori-arkeologjisë ose diplomë universitare e huaj**, e cila të jetë njohur nga Ministria përgjegjëse për arsimin, e barazvlefshme me diplomën e sipërcituar (Kopje e diplomës e noterizuar).
- 4. Diplomë e shkollës pasuniversitare (master shkencor) brenda ose jashtë vendit** të njohur nga Ministria përgjegjëse për arsimin, në arkeologji dhe nëndegët e saj
- 5. Eksperiencë si pjesëmarrës në të paktën 5 (pesë) projekte për veprimtari arkeologjike**, brenda dhe/ose jashtë vendit, e vërtetuar nga dokumenti i konfirmuar (original ose fotokopje e noterizuar) nga institucioni apo nga drejtuesi i projektit.
- 6. Vetëdeklarim i individit mbi gjendjen e tij në lidhje me organet e prokurorisë dhe gjykatës**, për probleme në ushtrimin e veprimtarisë profesionale ku kërkon të licencohet, si dhe mbi angazhimin për të njohur e zbatuar në veprimtarinë e tij legjislacionin në lidhje me trashëgiminë kulturore
- 7. Veprimtaria e kryer nga marrja e diplomës deri në momentin e kërkesës**, vërtetuar nga institucionet përkatëse.
- 8. Kualifikimet apo specializimet dhe kontribute të veçanta** nëpërmjet certifikatave të lëshuara nga organet kompetente, të noterizuara.